



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXIV-të (njëzetekatër - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 05 gusht 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Bahri Selimi Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE, Tamas Pap përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent për momentin, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete të mbajtura më 06 qershor 2024 dhe 05 korrik 2024

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi 2 procesverbale në këtë pikë të rendit të ditës nga dy mbledhjet paraprake të Komitetit, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën nëse jo atëherë e hedh në votim veç e veç këto procesverbale sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06.06.2024.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06.06.2024.

2. Diskutim për projektet e infrastrukturës dhe shërbimeve publike që ndikojnë në sigurimin e qytetarëve dhe drejtpërdrejt të komuniteteve jo shumicë të cilat mund t’iu prezantohen Drejtorive përkatëse për shqyrtimin e mundësive për përfshirjen e tyre në projekt buxhetin e komunës për vitin 2025

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, fillimisht falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit për prezencën e tij në këtë mbledhje.

Sa i përket çështjes së projekteve të infrastrukturës publike për komunitetet jo shumicë, me theks në lagjen ku jetojnë në rrugën “Ali Ajeti”, drejtori i DSHPMSh veç është i njoftuar për çështjen e ujësjellësit, mirëpo kjo çështje nuk është në rend të ditës sepse edhe Kompania e Ujësjellësit nuk ka kthyer përgjigje edhe pse ne ju kemi drejtuar atyre me projekt por sërish përgjigje nuk kemi marr, kështu që ka mbet që kjo çështje të bisedohet edhe njëherë me Komunën.

Po ashtu në këtë lokalitet, me theks në lagjen e parë ashtu siç e quajmë ne sepse kemi dy rrugica në atë lokalitet, si prioritet është ndriçimi i lagjes, aty ka qenë ndriçimi por me vendosjen e shtyllave të reja nga ana e KEDS është eliminuar dhe kjo lagje ka mbetur pa ndriçim. Kanalizimi në atë lagje është në rregull, funksionon pa problem dhe nuk kemi telash lidhur me këtë, pra në përgjithësi në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr. “Ali Ajeti” përveç ujit / ujësjellësit dhe pjesës së ndriçimit si dhe dy rrugicave që janë në kubza, infrastruktura është në rregull.

Për lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.”Xhafer Meta” kemi këtu anëtarin e Komitetit e cila është edhe përfaqësuese e asaj lagjeje e cila mund të na jap informata.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, sa i përket lagjes ku jetojnë komunitetet jo shumicë në rr.“Xhafer Meta”, ndriçimi publik në disa pjesë nuk funksionon, në disa po, kurse sa i përket çështjes së kanalizimit kemi biseduar më parë rreth problemeve me gypa në atë pjesë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, si duket parafolësja nuk paska shënime dhe informata sa duhet, por sipas informatave që kam unë, në lagjen në fjalë kanë problem me kanalizim edhe pse aty është bërë kanalizimi por sërish ka probleme dhe është e nevojshme të shikohet gjendja e atij kanalizimi se ku ka ngecur apo ku është bllokuar sepse disa qytetarë aty pretendojnë se janë të kyçur vetëm disa familje dhe disa të tjerë e theksojnë të kundërtën, pra unë sakët nuk e di për këtë çështje por e di që aty kanë probleme me kanalizim, dhe përveç kësaj në atë lagje janë edhe 2 rrugë të cilat duhet të rregullohen me kubza.

Në fshatin Orllan ku jetojnë komuniteti jo shumicë, përfaqësuesi i asaj pjese më ka treguar që paraqitet nevoja për rregullimin e një pusete me qëllim që ujërat e zeza të mos e ndotin Liqenin.

Përveç kësaj, me sa kam informacion unë është bërë kërkesë që në atë lagje në fshatin Orllan të shtrohet një rrugë me kubza e që për këtë besoj se drejtori i DSHPMSh do të na informon se a është një kërkesë e tillë apo jo.

Në fshatin Sfeqël është bërë kërkesë në Komunë lidhur me një kanalizim afërsisht 30 metra ngase aty një familjeje po i depërton uji brenda sa herë që ka të reshura, pra po i bëhen dëme asaj familje.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, po ashtu ju informoj se e kam vizituar lagjen në rrugën ”Bedri Ahemti” në Podujevë, konkretisht te pjesa nga lumi dhe kur po ka reshje të shiut në sasi më të madhe, uji po depërton brenda në oborr sepse kanalizimi bllokohet shpesh aty dhe ka probleme.

z.Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, fillimisht ju falënderoj për ftesën që më keni bërë të jem prezent në këtë mbledhje në mënyrë që t’i marr kërkesat e juaja, me theks shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri sepse nuk kam qenë njoftuar deri sot për këtë takim që mbahet, mirëpo u njoftova dhe u përgatita që të jem në këtë takim meqë bëhet fjalë për pikën e dytë të rendit të ditës lidhur me infrastrukturën publike e që do të mundohem t’i marr të gjitha kërkesat e juaja.

Sa i përket kërkesave të cilat u parashtruan këtu thuajse për të gjitha kemi njohuri, janë kërkesa që kanë ardhur edhe individualisht nga përfaqësuesit e juaj apo komuniteteve jo shumicë dhe ne jemi duke e shqyrtuar çdo kërkesë që është sjellë nga ju e që po mundohemi që të bëjmë zgjedhje sa më të shpejt edhe pse e keni parasysh që zgjedhjet nuk janë të shpejta për shkak të projekteve që duhet të bëhen fillimisht.

Ne në vitin e kaluar kemi bërë kërkesë në Ministrinë përkatëse për realizimin e disa kërkesave, mirëpo fatkeqësisht ai projekt nuk ka kaluar dhe tash prapë na ka mbet barrë neve si Komunë që të merrmi me këto kërkesa në mënyrë që të kemi mundësi t'i përfundojmë sa më shpejt dhe sa më mirë që është e mundshme.

Sa i përket kërkesave të para që u përmenden për rrugët, kanalizimet si dhe mirëmbajtjen e tyre, krejt këto janë kërkesa të vogla dhe besoj që ka mundësi për t'i shqyrtuar dhe ekzekutuar më shpejt në një afate sa më të shkurt të mundshëm, ndërsa një pjesë që më bëri përshtypje është kërkesa e fundit që ka të bëjë me kanalin i cili kalon në lagjen ku jetojnë komunitetet jo shumicë në rr."Xhafer Meta" e që paraqet probleme jo vetëm për komunitetin por për gjithë banorët që jetojnë në atë pjesë dhe që për këtë problem kemi pas kërkesa nga të gjithë banorët pothuajse, andaj mund t'ju them se jemi duke hartuar projektin për trajtimin e lumenjve ku bënë pjesë edhe ai kanal i cili është i madh dhe paraqet probleme të shumta, mirëpo ne jemi në projektim të këtij kanali dhe jemi duke menduar që ta bëjmë kanal të hapur të betonuar, pra duhet të hapet dhe të zgjerohet, bëhet betonimi i tij në mënyrë që të mos ketë probleme tjera në vazhdim, betonimi i këtij kanali mendojmë që do të bëhet siç jemi duke e projektuar nga rruga magjistrale të "AGNESA" ku fillon ky kanal dhe deri te ura në rr."Skënderbeu" që nënkupton se e përfshin gjithë atë lagje dhe mendojmë që të paktën kjo pjesë që është në mes dy rrugëve kryesore të mos ketë më probleme, ndërsa pjesa tjetër mbi rrugën "Skënderbeu" edhe aty ka probleme sidomos gjatë vërshimeve dhe fillimisht po shpresojmë të hapim kanalin dhe besoj që me hapjen dhe rregullimin e kanalit nuk do të ketë më probleme.

Për këto kërkesat e tjera, siç ju thash në fillim ne vetëm kemi filluar të veprojmë diçka aty, ndërsa me ujin e pijes në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" kemi kontaktuar disa herë me kompaninë e Ujësjellësit, pra është kompetencë që i takon KRU "Prishtina", nuk është kompetencë e Komunës, mirëpo ne po mundohemi që të ruajmë kontaktet me atë kompani dhe t'i nxisim që të rregullojnë ujin e pijes sepse unë e di që ka probleme aty, dhe sa për informacionin e juaj dy ditë më parë është dashtë që me një cisternë të bëhet furnizimi i një lagjeje aty në një pus (bunar) të cilin e kemi mbushur me ujë për nevoja të pastrimit të atyre familjeve sepse uji që hedhet me cisternë në pus nuk është ujë për pije, mirëpo për pastrim ka mundësi të përdoret, prandaj një banor i lagjes në fjalë ka bërë një kërkesë dhe ne e kemi dërguar një cisternë dhe e kemi mbushur atë pus (bunar) me ujë sa për të bërë një zgjedhje të përkohshme deri sa të bëhet rregullimi i ujit.

Ndriçimi publik është një projekt që nuk kemi bërë investim në këtë vit, por jemi duke menduar që tani të lidhim një kontratë e që merr pa kohë dhe ju them që shumë shpejtë kryhet kjo punë, pra kontrata merr pak kohë deri sa të lidhet.

Për rrugët me kubza, jemi pran lidhjes së kontratës dhe po shpresoj që në momentin që lidhet kontrata unë kërkesat e juaja veç i mora dhe i evidentova e që disa prej tyre do t'i përfundojmë me kontrata të këtij viti sepse kemi mundësi, ndërsa disa tjera kemi të planifikuara për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Pra kjo ishte ajo që deshta të them dhe t'ju përgjigjem për fillim, por nëse keni ndonjë kërkesë apo ndonjë pyetje shtesë jeni të mirëseardhur.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës për informatat e ofruara, vërtetë nuk e kam dit që është bërë ajo punë që e ceke sepse është projekt i mirë dhe shumë i qëlluar, por e kam një pyetje për ju, për fshatin Orllan dhe Sfeqël a është sjellë ndonjë kërkesë.

z.Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, për fshatin Sfeqël nuk më kujtohet për momentin që është sjellë ndonjë kërkesë, ndërsa për fshatin Orllan më duket ka qenë një person që ka bërë një kërkesë për një rrugë me kubza, por unë tani i mora edhe kërkesat e juaja por edhe nëse nuk ka ardhur ndonjë kërkesë nga fshati Sfeqël, ne e marrim për bazë edhe kërkesën që del nga kjo mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, besoj që kur të bëhet buxheti t'i keni parasysh këto kërkesa sepse e dimë që këto projekte shkojnë më ngadalë, por kërkesat i morët dhe i evidentuat dhe besoj që dhe do t'i përfundoni.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, fillimisht falënderoj drejtorin e DSHPMSh që është pjesë e kësaj mbledhje shumë me rëndësi dhe është shumë mirë që merren informacionet e drejtpërdrejta nga shumica e anëtarëve të Komitetit për Komunitete dhe nga anëtarët e komunitetit jo shumicë secili nga lagjet e tyre ku jetojnë e që kjo është diçka e mirë për planifikimin e buxhetit. Pra për këto kërkesa që i keni informacionet dhe që i ke pas edhe më herët janë të mirëseardhura, është e mirë sepse drejtpërdrejt u jepën informacionet edhe nga ana e drejtorit të DSHPMSh për mundësit që ka Komuna në këtë vit dhe në vitin e ardhshëm.

Dua që të informoj për fshatin Sfeqël, unë personalisht e kam vizituar fshatin Sfeqël përkatësisht komunitetin ashkali ku ata e kanë një problem me ujin që vije nga pjesa e sipërme e fshatit Lladoc e që është një kanal diku afërsisht 70 metra i cili është e nevojshme të hapët, problem për të cilin sigurisht se mund të dalin në vendngjarje edhe inxhinierët e Komunës dhe të shohin saktë gjendjen e tij. Kërkesë me shkrim për këtë nuk ka pas, por sa për informacion fjala është për 3 familje të cilat gjenden në atë pjesë dhe kur ka vërshime pengohen shumë nga vërshimet, megjithatë me ato familje kam biseduar dhe i'u kam kërkuar që është mirë të depononi kërkesë me shkrim.

Ju bëjë thirrje të gjithë përfaqësuesve të lagjeve ku jetojnë komunitetet jo shumicë që kërkesat është e rrugës t'i dërgoni me shkrim në Drejtorinë përkatëse sepse ajo mbetet dokument valid dhe kërkesa shqyrtohet nga organet ku edhe mund të dalin në vendngjarje, pra me daljen e inxhinierëve në teren ata mund ta dinë saktë kapacitetet dhe mundësit qoftë për ndriçim, gypa etë tjera, pra kjo është ajo që është në interes të qytetarëve sepse janë projekte për sigurinë e qytetarëve. Ne të gjithë jetojmë dhe veprojmë këtu dhe e dimë që ndriçimi, kanalizimi si dhe projektet tjera neve nuk na ndajnë por na bashkojnë, dhe është mirë që me gjitha mundësitë që janë të merren parasysh këto projekte, projekte të cilat duhet të analizohen sepse nuk janë projekte të mëdha, përveç problematikës që nga viti 2022 është bërë problem çështja e ujit dhe vendosja e gypave për çka ne e kemi diskutuar këtë çështje disa herë dhe e kemi dërguar këtë edhe tek institucionet qendrore, prandaj besoj që edhe kjo çështje do të rregullohet që është projekt shumë i rëndësishëm për atë lagje dhe ata banorë sepse është edhe lagje bukur dhe e madhe ku ka edhe të komuniteteve shumicë që ndoshta, e që ndoshta është e nevojshme të ndërrohen gypat që janë të asbestit, çështje të cilën drejtori i DSHPMSh veç se e ka paraparë, mirëpo këto shkojnë me marrëveshje tjera që bëhen me kontrata, qoftë me Kompaninë e Ujësjellësit, qoftë me donatorë apo me Qeverinë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe një pyetje e kam për drejtorin e DSHPMSh, deri kur ka kohë / afat që komunitetet jo shumicë të bëjnë kërkesa me shkrim në mënyrë që të mos jemi vonë për buxhet.

z.Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, koha e paraqitjes së kërkesave është qysh tash, pavarësisht se nga muaji janar e këndeje çdo kërkesë që vie është në kohën e duhur.

Buxheti për vitin e ardhshëm është në përgatitje e sipër për miratim, faza e parë vetëm ka kaluar dhe në fund të muajit shtator është data e fundit kur aprovohet në Kuvend, mirëpo atëherë është vonë kurse tani jemi në fazën e fundit kur mund të paraqitni kërkesat me qëllim që të implementohen në vitin e ardhshëm.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, duke i falënderuar parafolësit për diskutimet, përgjigjet dhe sqarimet e dhëna.

3. Të Ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë çështje në pikën Të Ndryshme, nëse jo atëherë e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0051133/24
Podujevë, 05 gusht 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**